

Mirel Josa: Nese nuk fitojme me Besen do te komplikojme objektivat

nga AlbaniaSoccer

E premte, 22 Nentor 2013 21:02



Skenderbeu luan ne Kavaje nje ndeshje mjaft delikate. Josa i ka pothuajse te gjithë lojtaret gati dhe deshiron shume te riktheje skuadren e tij tek fitorja. “Nuk do te jete aspak e lehte. Besa ka nje skuader mjaft te forte dhe sa here luajne ne shtepi ata jane nje ekip qe nuk thyhen lehte. Ne na duhet te japim shpirtin ne fushe per te marre maksimumin. Nese duam te mos e leme kreun duhet te fitojme ne kete transferte qe te nisim fazen e dyte me ritmin e duhur jo si beme me fillimin e kampionatit. I respektoj kundertshtaret dhe i njoh pikat e tyre te forta. Na duhet te mobilizohemi ne maksimum dhe kete ja kam shprehur te gjithë skuadres ne analizat qe kemi bere”, ka deklaruar para ndeshjes me Besen trajneri i Skenderbeut Mirel Josa.